


Version i shkurtuar

Popullata shumicë dhe pakica muslimane në Zvicër

Mendimi i KFR-së lidhur me situatën aktuale



Komisioni Federal
kundër Racizmit (KFR)

Bernë,
Shtator 2006

fc₁
ek₁

Version i shkurtuar

Popullata shumicë dhe pakica muslimane në Zvicër

**Mendimi i Komisionit Federal kundër Racizmit (KFR)
lidhur me situatën aktuale**

Bernë, shtator 2006

Përfundimi i redaktimit: 30 qershor 2006

Version i shkurtuar

**Popullata shumicë dhe pakica muslimane në Zvicër
Mendimi i KFR-së për situatën aktuale**

Bernë, shtator 2006

Përfundimi i redaktimit: 30 qershor 2006

© EKR-CFR / 2006

Boton	Komisioni Federal kundër Racizmit (KFR)
Redaktimi	Doris Angst, me ndihmën e Sabine Kreienbühl dhe Tarek Naguib
Përkthimet	Stéphane Rigault (français) Servizi linguistici SG-DFI (italiano) bmp translations ag (English)
Dizajni grafik	Monica Kummer Color Communications, Zug
Download (PDF)	http://www.edi.admin.ch/ekr/dokumentation
Për porosi të një ekzemplari të botuar (teksti komplet: CHF 10, versioni i shkurtuar: CHF 5) kontakto:	FCR Secretariat, GS-EDI CH-3003 Berne Tel. +41 31 324 12 93 Fax. +41 31 322 44 37 E-Mail: ekr-cfr@gs-edi.admin.ch www.ekr-cfr.ch

1. Pikënisja dhe qëllimet

Komisioni Federal kundër Racizmit KFR (Die Eidgenössische Kommission gegen Rassismus [EKR]) brenda mandatit të saj merret me çdo formë të diskriminimit racor, ku bën pjesë edhe kufizimi apo diskriminimi në bazë të fesë. Qëllimi i kësaj kumtese është përshkrimi dhe prezantimi i marrëdhënieve të komunitetit shumicë me pakicën muslimane në vendin tonë - marrëdhënie që në dy dekadat e fundit kanë pësuar mjaft ndryshime. Përmes analizës së debateve publike, përmes shpalosjes së mekanizmave përjashtuese dhe diskriminuese kundër muslimanëve si dhe përmes propozimeve e rekomandimeve për veprim, KFR-ja ka për qëllim stimulimin e mirëkuptimit të popullatës shumicë ndaj asaj pakicë. Me këtë rast nuk bëhet fjalë për dallimin ose theksimin e veçorive kulturore ose fetare të një grupi apo për shpalljen e një statusi të veçantë të tyre. Për më tepër, qëllimi është të arrihet një pranim në bashkëjetesën e përditshme, të definuar sipas “All different – all equal” (“të gjithë ndryshe-të gjithë njësoj”, kampanjës aktuale rinore të Këshillit të Evropës), trajtim i barabartë me respektimin e njëkohshëm të dallimeve.

Mendimi aktual i drejtohet shoqërisë civile zvicerane në përgjithësi, por në veçanti bartësve të vendimmarrjes dhe përfaqësuesve të politikës, anëtarëve të organeve publike dhe përfaqësuesve të ekzekutivit, medieve, përgjegjësve të integritit, ndërmjetësve dhe këshilltarëve, inspektorëve të komiteteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfaqësuesve të kishave të vendit dhe bashkësive të tjera fetare. Tekefundit ky mendim duhet të shërbejë si një instrument mbrojtës për njerëzit me përkatësi fetare muslimane që jetojnë në vendin tonë, pavarësisht nëse janë ata ushtrues të këtij besimi ose jo. KFR-ja e vë veten në dispozicion si ndërmjetës për të gjitha kategoritë e banorëve të vendit, për t’i realizuar synimet e skicuara nga ana e saj lidhur me raportet e popullatës shumicë me pakicën muslimane.

1.1. Puna fillestare: Studimi “Muslime in der Schweiz. Identitätsprofile, Erwartungen und Einstellungen” (“Muslimanët në Zvicër. Profile identitetesh, parashikime dhe qëndrime”) i publikuar nga Die Eidgenössische Ausländerkommission (EKA) (Komisioni Federal për të Huajt [KFH]) në tetor të vitit 2005, është bazuar në një anketë të zhvilluar me tridhjetë muslimane e muslimanë të zgjedhur si përfaqësues. Ai e skicon situatën e pakicës muslimane në Zvicër nga aspekti i procesit të integritit. Të dyja publikimet – edhe ajo e KFH-së edhe kjo e KFR-së – e plotësojnë rekomandimin nr. 4 të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), i cili kërkon prej qeverive të bëjnë studimin dhe vëzhgimin e grupeve që mundësisht mund të bien pre e racizmit.

1.2. Faktet për popullatën muslimane të Zvicrës janë me rëndësi, mirëpo ato shumë lehtë mund të përdoren për qëllime manipuluese. Numri i muslimanëve që sot jetojnë në

Zvicër vlerësohet të jetë 340'000 (sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2000: 310'807). Kjo do të thotë një rritje e madhe krahasuar me numrin 16'353 të vitit 1970. Muslimanët që jetojnë në Zvicër rrjedhin nga mbi 100 vende të ndryshme të botës dhe u takojnë bashkësive të ndryshme të besimit islam. Përkatësitë e ndryshme nacionale ndonjëherë janë më përcaktuese sesa përkatësitë më pak a më shumë të përbashkëta fetare. Grupi më i madh i takon Islamit sunnit, të tjerët janë shiitë, alevitë etj. Shumica vijnë nga ish-Jugosllavia dhe nga Shqipëria, pastaj nga Turqia si dhe nga shtetet arabe e afrikanoveriore. Vetëm 12 % e muslimanëve sot janë shtetas të Zvicrës. Sipas studimit të KFH-së vetëm 10 deri 15 % e pjesëtarëve të besimit islam e ushtrojnë besimin e tyre. Për pjesën dërmuese të muslimanëve, veçanërisht për gjeneratat më të reja, feja sot është më tepër një traditë familjare sesa një shprehje e mbjellë në jetën e përditshme. Muslimanët e Zvicrës janë të organizuar në përreth 300 organizata, shumica prej të cilave janë themeluar si shoqata e klube private. Në nivelin kombëtar, mbirajonal, veprojnë këto organizata: *Ligue des Musulmans de Suisse (LMS)*, *Fondation culturelle islamique (FCI)*, *Muslime*, *Musliminnen der Schweiz (MMS)*, *Die Koordination islamischer Organisationen (KIOS)* dhe që nga pranvera e vitit 2006 edhe *Die Föderation Islamischer Dachorganisationen in der Schweiz (FIDS)*.

1.3. Konceptet: Stereotipet (shabllonet) dhe paragjykimet antimuslimane përgjithësisht mbështeten në projekte që veprojnë pa i marrë parasysh tiparet dhe veçoritë individuale dhe kolektive të caktuar. Stereotipet kundër muslimanëve pjesërisht kanë rrënjë të lashta historike. Në fakt, diskriminimet ndaj muslimanëve kanë filluar shumë përpara luftërave të Evropës juglindore ose barazimit / identifikimit të Islamit me terrorizmin pas 11 shtatorit të vitit 2001. KFR-ja në këtë tekst e përdor termin muslimofobi, për ta theksuar një armiqësi kundër njerëzve të cilët veten e quajnë muslimanë. Ky term duket më i përshtatshëm sesa termi Islamofobi, term ky i cili shikuar nga aspekti semantik më shumë e vë theksin mbi Islamin si fe. Në gjuhën frënge dhe angleze termi Islamofobi përdoret madje edhe në të njëjtin kontekst me antisemitizmin për ta identifikuar me një ideologji antimuslimane të motivuar nga arsye raciste. Termi Islamizëm në diskursin e sotëm të vendeve perëndimore përdoret për ta shënuar atë ideologji politike e cila Islamin e përdor si arsyetim të qëndrimeve ekstremiste, fundamentaliste si dhe patriarkale.

1.4. Korniza juridike: sistemi juridik ndaj edhe të drejtat elementare dhe njerëzore vlejnjë për të gjithë personat që janë të pranishëm brenda territorit të Zvicrës. Të një rëndësie fundamentale për pjesëtarët e një feje pakicë janë: ndalimi i diskriminimit sipas së drejtës kushtetuese dhe ndërkombëtare (neni 8, paragrafi 2 i Kushtetutës Federale-KF; neni 14 në lidhje me nenin 9 të (EMRK-Europäische Menschenrechtskonvention ose ECHR-European Court of Human Rights - Gjyqit Evropian për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut); neni 2, paragrafi 1 në lidhje me nenin 18 të Konventës II të OKB-së); liria fetare dhe e ndërgjegjes

(neni 15 i KF-së; neni 9 i EMRK-së; neni 18 i Konventës II të OKB-së); e drejta penale kundër diskriminimit racor (neni 261^{bis} i Kodit Penal të Zvicrës), ndalimi i ndërhyrjes në lirinë e besimit e të kulturës (neni 261 i Kodit Penal të Zvicrës) si dhe mbrojtja e personalitetit (neni 27 e më tej i Kodit Civil të Zvicrës). E drejta zvicerane sjell kufizime për të gjitha ato akte që e lëndojnë apo shkelin personalitetin respektivisht dinjitetin e njeriut, qetësinë sociale ose përgjithësisht sistemin juridik të shtetit – pa marrë parasysh përkatësinë fetare të kundërvajtësit. Marrëveshja Kornizë Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (The International Framework Convention for the Protection of National Minorities – IFCPNM) i mbron pjesëtarët e pakicave në ushtrimin kolektiv të gjuhës, kulturës dhe fesë. Sipas definicionit të zbatuar në Zvicër, në të ardhmen edhe muslimanët do të njihen si pakicë kombëtare me kusht që të kenë hyrë në Zvicër brenda një kohe relativisht të gjatë.

2. Diskursi publik

Në Zvicër diskursi publik mbi muslimanët ka filluar në intensitet vonë para do kohësh si rezultat i imigrimit të shtuar viteve të fundit të muslimanëve dhe si rezultat i gjendjes së politikës botërore. Krahas kësaj, në këtë diskutim publik ndikojnë edhe ato çka ndodhin gjithandej nëpër Evropë. Qysh në prill të vitit 2000 Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës i Këshillit Evropian (ECRI) në rekomandimin e pestë të përgjithshëm i është përkushtuar temës së intolerancës dhe diskriminimit ndaj muslimanëve, me ç'rast paralajmëroi për konceptet stereotipe mbi Islamin dhe për diskriminimin e pjesëtarëve të besimit islam. Qendra Evropiane për Monitorim mbi Racizmin dhe Ksenofobinë (EUMC) në nëntor të vitit 2001 publikoi një studim lidhur me situatën e bashkësive islame në pesë shtete evropiane, të mbështetur në kërkimet e kryera para sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001. Me këtë rast u konstatua se paragjykimet dhe armiqësia kundër muslimanëve në të gjitha shtetet evropiane shpesh çon në diskriminimin dhe izolimin shoqëror të tyre. Qendra Evropiane për Monitorim ka shënuar se muslimofobia është rritur sidomos në vitet e nëntëdhjeta.

Mirëpo ekzistojnë edhe disa veçori që janë karakteristike për Zvicrën: pranimi i pluralizmit është pjesë e sistemit politik zviceran, me shumëllojshmërinë (autoktone) të së cilës mburren njerëzit. Sfida e sotme qëndron në atë që kjo shumëllojshmëri (nacionale, fetare etj.) të pranohet dhe integrohet në një kuptim edhe më të gjerë. Nga njëra anë, sistemi i drejtpërdrejtë demokratik hap një kanal për zërat ksenofobikë, si për shembull me rastin e fushatave elektorale. Kurse nga ana tjetër, qëndrimi zviceran ndaj pakicave gjithnjë është karakterizuar me një pragmatizëm të madh, ku bëjnë pjesë edhe tiparet e veçoritë

regjionale. Kështu në Zvicrën gjermane liria fetare çmohet më shumë sesa në pjesën franceze, ku më shumë rëndësi i jepet shtetit shekullar (*laïcité de l'Etat*).

Sipas mendimit të KFR-së **debatet publike** në Zvicër mund të karakterizohen si në vijim:

1. Diskursi është ndikuar nga ngjarjet që kanë ndodhur jashtë vendit dhe të cilat shpesh janë bartur në Zvicër, pa marrë parasysh faktin se këtu situata ka qenë gjithnjë e qetë.
2. Qëndrimi ndaj muslimanëve në Zvicër ndryshon vetëm në shkallë të qëndrimeve të njëjta ndaj muslimanëve në vendet e tjera evropiane. Tendenca kryesore e një diskriminimi në bazë të përkatësisë fetare në Evropë ka qenë e pranishme shumë më gjatë përpara sulmeve të 11 shtatorit 2001 në Nju Jork.
3. Deri vonë kohëve të fundit diskursi politik është zhvilluar *rreth* muslimanëve e jo *me* muslimanët.
4. Në sjelljen me muslimanët shpeshherë është marrë në konsideratë vetëm përkatësia e tyre fetare, edhe pse shumica dërmuese e muslimanëve të Zvicrës nuk e jetojnë Islamin në praktikë. Kjo pamje e shtrembëruar para së gjithash në plan të parë i vendos çështjet fetare, me ç'rast interesat që kanë të bëjnë me çdo individ, si statusi social, arsimimi etj., shtyhen në prapaskenë.
5. Muslimanët shënohen sipas imazheve të praktikave tradicionale fetare, madje edhe atëherë kur këta s'kanë të bëjnë fare me to. Kështu, martesat e detyruar, vrasjet në emër të nderit dhe gjymtimet gjënitale, në një kombinim ogurzi lidhen me të gjithë muslimanët.
6. Pranimi i muslimanëve lidhet e kushtëzohet me "sjelljen e mirë" të tyre.
7. Në të njëjtën kohë, muslimanët janë vënë përballë një presioni për t'u deklaruar për një identitet hamendshëm njëtrajtësh, të cilin s'e gjen dot në asnjë fe.
8. Muslimanët në Zvicër në dekadat e fundit – të ndërlidhur me situatën e politikës ndërkombëtare – janë shndërruar në dash kurbanit të ri. Njerëzit që jetojnë këtu njollosen në mënyrë kolektive dhe futen në një thes të përbashkët.
9. Shumë shpesh nëpër medie paraqiten stereotipe negative lidhur me muslimanët. Pamjet negative priren të mëvetësohen dhe të nguliten nëpër kokat e njerëzve.
10. Aktorët politikë gjithë e më tepër po i përdorin stereotipet lidhur me muslimanët për qëllimet e tyre politike.

KFR-ja ka konstatuar disa risi në qëndrimin dhe në **pamjen publike** të vetë muslimanëve. Kështu për shembull ata e kanë pasur vështirë që çështjen e tyre ta nxjerrin në pah më fuqishëm, ngase nga mediet vendase ata kanë qenë futur nën një dyshim të përgjithshëm të terrorizmit. Në zënkat për karikaturat dhe në debatet e muajve të fundit për integrimin e muslimanëve në shoqëri, krahas përfaqësuesve të bashkësive fetare, për herë të parë edhe përfaqësues të muslimanëve shekullarë e morën fjalën dhe shprehën qëndrimet e tyre, me çka ata prezantuan një imazh dhe pamje të re e të shumëllojshme. Brendapërbrenda bashkësisë muslimane në Zvicër është ndezur një diskutim i ri për luftën kundër terrorizmit, për integrimin, për qytetarinë (shtetësinë) dhe për statusin e fesë në Evropë, diskutim ky i cili po bartet edhe në publik.

2.1. Edhe në Zvicër **pas 11 shtatorit 2001** muslimanët janë futur nën një dyshim të përgjithshëm të terrorizmit dhe kjo vazhdon sot e kësaj dite në forma të ndryshme. Në raportin e plotë të saj KFR-ja prezanton elementet më kryesore të këtij diskutimi. Për dallim prej vendeve të tjera evropiane, në Zvicër ka pasur vetëm disa raste të izoluara të sulmeve të dhunshme kundër muslimanëve.

2.2. Pa pretenduar se ka kryer ndonjë hulumtim të hollësishëm për mediet, KFR-ja e interpreton **rolin e mjeteve të komunikimit**. Shkurt e lirshëm mund të themi se mediet shumë vonë kanë filluar të bisedojnë me muslimanët, në vend të asaj që më parë kanë shkruar për muslimanët; se akoma shumë shpesh po raportohet për muslimanët në mënyrë negative dhe vetëm në kontekst të aktiviteteve terroriste islamiste, me çka i nxisin dhe mbështesin paragjykimet; se muslimanët po diskreditohen përmes titujve sensacionalë ose reklamave politike dhe se letrat e lexuesve shpesh po shkruhen në formë nxitëse dhe diskriminuese.

2.3. Në një fazë më të re, diskutimi publik u fut në **të ashtuquajturën grindje për karikaturat**. Në fillim të 2006 për shkak të botimit të karikaturave të profetit Muhammed në të gjitha mjetet e komunikimit zviceran u kall debati për lirinë fetare nga njëra anë, dhe lirisë së shprehjes së mendimit e të shtypit nga ana tjetër. Kjo shkaktoi një debat e diskutim të thelluar me njerëzit që jetojnë këtu e që i përkasin besimit fetar islam. Mediet ua mundësuan si muslimanëve praktikues ashtu edhe atyre shekullarë që t'i shprehnin mendimet e tyre. KFR-ja e vlerëson këtë si një progres në dialogun ndërfaqetor dhe ndërkulturor, ku morën pjesë aktive edhe kishat e vendit.

2.4. Shpesh, në kontekst të integritetit dhe lirisë fetare po ngjallet "**debati mbi shaminë**". Shamia (mbulesa islame) me këtë rast shërben edhe si simbol i dallimeve kulturore, po edhe si shenjë e shtypjes së femrës. Për herë të parë kjo ndodhi kur një mësuese e konvertuar në Gjenevë filloi ta bartte shaminë, të cilës e njëjta iu ndalua në vitin 1997 përmes një vendimi të Gjykatës së Lartë me pretekstin se ajo, me pozitën e saj si mësuese, e përfaqësonte shtetin shekullar. Gjykata administrative e Neuchâtel-it vendosi që nxënëset të mund ta bartnin shaminë në shkollë si persona privatë. Shamia shkaktoi një ndjesi në vitin 2004, kur një arkëtare e Migros-it dëshironte ta bartte shaminë. Si rezultat i kësaj, dy shpërndarësit më të mëdhenj të mallrave, Migros-i dhe Coop-i, secili prej tyre hartuan politikat e tyre lidhur me bartjen e shamisë në vendin e punës, qoftë atje ku ka kontakt të drejtpërdrejtë me blerësit qoftë atje ku nuk ekziston një kontakt i këtillë. Shpeshherë ndodh që femrat të pushohen nga puna për shkak të bartjes së shamisë, ato nuk pranohen aspak në marrëdhënie pune ose vajzat e reja s'gjejnë dot stazh pune si nxënëse. KFR-ja shaminë e shikon para së gjithash si një formë të qëndrimit individual fetar dhe vetëm në raste të

izoluara si shprehje të një perceptimi fetar militant. Në Zvicër në asnjë rast shamia nuk duhet të barazohet me jotolerancën ose ekstremizmin.

2.5. Diskutimi publik është ndezur edhe lidhur me **ndërtimet fetare**. Muslimanët deri më sot kanë qenë të detyruar që besimin e tyre në formë kolektive ta ushtrojnë nëpër oborre shtëpish ose nëpër bodrume. Ndaj kërkesave për ndërtimin e minareve reagojnë me kundërshtim të gjithë banorët e komunës përkatëse. Ndaj asnjë pakice tjetër fetare nuk është treguar kaq pak mirëkuptim për nevojën e ndërtimit të objekteve të denja sakrale. Shembulli më i freskët është kërkesa për ndërtimin e një minareje në Wangen të kantonit Solothurn, e cila kah fundi i vitit 2005 në nivel kombëtar u shndërrua në një simbol të një konflikti "hapësinor" ndërmjet krishterëve dhe muslimanëve. Edhe përkundër mendimit paraprak juridik, i cili konsideronte se ekzistonte një përshtatshmëri rajonale "e pranueshme" për një minare në zonën industriale në fjalë, kërkesa për ndërtim u refuzua nga Këshilli Komunal nën pretekstin e rregullimit ndërtimor dhe rajonal. [Shtesë pas përfundimit të redaktimit të këtij raporti: Kanton Solothurni më datë 13.07.2006 e ka miratuar ankesën e shoqatave kulturore turke se ndërtimi përkon me kërkesat për zonën industriale dhe se objekti guxon të ndërtohet.]

2.6. Te shtrembërimi ka çuar edhe **diskutimi për shkeljen e sistemit juridik të Zvicrës**. Vetvetiu kuptohet që këto shkelje duhen ndëshkuar. Aktivitetet e kryera në mënyrë individuale, megjithëkëtë, nuk guxojnë të interpretohen si një provë për inferioritetin dhe pashkueshmërinë (papajtueshmërinë) kulturore të Islamit me Zvicrën. Ky rrezik është i madh sidomos nëse vrasja në emër të nderit, martesat e detyruara dhe gjymtimi i organeve gjinitale vihen në ballë të raporteve e reportazheve. Këto gjëra ndodhin, mirëpo këto nuk e përcaktojnë jetën e banorëve muslimanë në Zvicër.

2.7. Një rol të veçantë luajnë **aktorët politikë** dhe mbartësit e mendimit, pasi veprimet e tyre mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht në rrethet e gjera të popullatës. Në dhjetë vitet e fundit në mënyrë të shtuar muslimanët po instrumentalizohen për qëllime politike dhe po njollosen me stereotipe diskriminuese. Kështu ndodhi për shembull para referendumit të vitit 2004 për lehtësimin e marrjes së shtetësisë, kur një komitet mbipartiak me lajmërimet "Muslimanët së shpejti shumicë" dhe "A do ta përcaktojnë së shpejti muslimanët politikën tonë për femrat?" bëri reklamë kundër propozimit të referendumit. Pikëpamjet dhe qëndrimet e partive politike ndaj pakicës muslimane në Zvicër janë të datave më të reja dhe kanë të bëjnë me tema nga më të ndryshmet.

2.8. Si **aktorë të tjerë institucionalë** në diskutimet publike në radhë të parë duhen përmendur institucionet kishtarë, të cilat kanë krijuar zyra të specializuara për kontakte me bashkësitë muslimane. Projektet për avancimin e dialogut me Islamin janë mbështetur nga të tria kishat vendase si dhe nga Federata Zvicerane e Bashkësive Izraelite. Përpos zyrave

ndërfetare të destinuara vetëm për këtë qëllim, ekzistojnë edhe organizatat joqeveritare jofetare, të cilat në mënyrë aktive përpiqen për një dialog me muslimanët dhe angazhohen kundër diskriminimit të muslimanëve. Për autoritetet shkollore dhe për përgjegjësit e arsimit rëndësi të shkallës së parë ka mirëkuptimi ndërfetar; forma e mësimi shkollor mbi etikën, fenë dhe kulturën; mësimdhënia e bashkësive fetare nëpër lokalet e shkollave, si dhe – dhe kjo është tema më e shpeshtë – garantimi i përjashtimit nga disa veprimtari në bazë fetare. Në institucionet publike, për shembull në shëndetësi e në armatën zvicerane, gjithnjë e më shumë merret parasysh nevoja për pakicat, përfshirë këtu edhe muslimanët.

3. Diskriminimet në jetën e përditshme

Paragjykimet muslimofobike çojnë në akte diskriminimi në nivel institucional, strukturor dhe ndërnjerëzor. Diskriminimet ndodhin atje ku edhe duken: në përditshmëri. Shpesh vështirë për t'u kuptuar, ngjarjet e këtilla për të prekurit shkaktojnë një dëm shumë masiv. Ata kanë shtruar për shqyrtim përpara KFR-së një theksim të veçantë mbi çuarjen e një jete të rëndomtë si banorë të Zvicrës – qofshin këta praktikues të Islamit ose jo.

Nga perspektiva e saj KFR-ja thekson se:

- sa u përket të drejtave elementare ekzistojnë konflikte midis interesave të shumicës dhe pakicës.
- Instrumentet juridike për zgjidhjen e këtyre konflikteve të së drejtës elementare dhe njerëzore janë në dispozicion dhe do të përdoren. Për raste individuale do të vendoset sipas kompromisit.
- Interpretimi juridik i diskriminimit zhvillohet bashkë me shoqërinë, kështu që mund të ndodhë që në një pikë kohore të mëvonshme për të njëjtën çështje të vendoset ndryshe (sa i përket ushtrimit të fesë nga ana e muslimanëve kjo mund të ndikojë në vendimin e Gjykatës Federale lidhur me lirin nga mësimi i notit për një vajzë si dhe me ndalimin e bartjes së shamisë për një mësuese në shërbimin shtetëror).
- KFR-ja e përshëndet diskutimin publik për vlerat. Megjithatë kjo nuk guxon të zhvillohet me mosrespekt, me paragjykime e me poshtërime ndaj pakicës, porse duhet të zhvillohet bashkë me të.
- KFR-ja e kritikon kulturalizimin racist të diskutimit me Islamin. Për t'u kritikuar është edhe ndjellja e një përplasjeje mes qytetërimeve.

- KFR-ja e kritikon kategorizimin gjithnjë të ndryshueshëm të njerëzve sipas përkatësisë fetare dhe prejardhjes kombëtare/etnike të tyre.
- KFR-ja e kritikon përsëritjen e vazhdueshme të një integrimi të dështuar të muslimanëve e muslimaneve, çka nuk përkon me realitetin.

KFR-ja ka shënuar akte direkte ose indirekte diskriminimi, ku e drejta elementare dhe njerëzore përbëjnë standarde të qarta, mirëpo ku trajtimi i barabartë nuk mund të garantohet ndryshe vetëm se në dëm të përkatësisë fetare ose të një diferencimi të fshehur etnik. **Kështu është rasti,**

- kur refuzohen kërkesat e bashkësive muslimane për qendra fetare brenda kornizave të rregullimit ndërtimor dhe rajonal, edhe pse rregullimi rajonal e lejon këtë;
- kur një varrim i denjë në varrezat publike u mundësohet vetëm pjesëtarëve të feve shumicë;
- kur bëhen diskriminime në jetën shoqërore në bazë të përkatësisë fetare, gjë kjo që nuk ka kurrfarë kuptimi;
- kur gjatë procedurës së marrjes së nënshtetësisë kërkesat e shtruar te nivelet komunale refuzohen për shkak të përkatësisë fetare, respektivisht për shkak të origjinës kombëtare ose etnike të shtruesit të kërkesës;
- kur kërkuesit për punë nuk merren në punë, ose nxënësve nuk u jepet stazhi i punës, për shkak të etnisë, po madje edhe për shkak të emrit ose të një simboli të dukshëm fetar që bart. Po kështu edhe ndarja e caktimi i vendit të punës, qoftë në kontakt të drejtpërdrejtë me klientët qoftë – për shembull – në depo (magazinë), nuk guxon të bëhet në bazë të fesë;
- kur shkarkimi nga puna bëhet në bazë të fesë ose të një simboli të dukshëm fetar;
- kur nuk lejohet kremtimi i festave fetare dhe kur nuk praktikohet trajtimi i barabartë i feve të ndryshme lidhur me këtë çështje;
- kur nuk ekziston trajtim i barabartë me rastin e lirimimit nga aktivitetet shkollore;
- kur aktorët politikë dhe drejtuesit e medieve raportojnë me stereotipe dhe pa pikë respekti ndaj muslimanëve dhe muslimaneve;
- kur dikujt i mohohet e drejta politike, si për shembull anëtarësimi në një këshill shkollor, vetëm për arsye fetare.

4. Rekomandimet e KFR-së

Për ta kundërshtuar diskriminimin dhe diskreditimin e konstatuar ndaj muslimanëve, KFR-ja u drejtohet me disa rekomandime shoqërisë civile në përgjithësi, e në veçanti vendimmarrësve, politikanëve dhe udhëheqësve të partive politike, drejtuesve të medie, autoriteteve arsimore si dhe shkollave. KFR-ja e thekson **Programin pesë pikësh “Për një politikë të përbashkët kundër racizmit”** të prezantuar me rastin e dhjetëvjetorit të ekzistimit të saj dhe e cila mbështetet në kërkesat e Konferencës Botërore të OKB-së kundër racizmit të mbajtur në Durban në vitin 2001:

1. Luftimi i racizmit dhe i diskriminimit është një detyrë e vazhdueshme e mbarë shoqërisë;
2. Duhet të përforcohen mjetet juridike për mbrojtjen e viktimave;
3. Për t'i mbrojtur të prekurit nga këto nevojiten oferta ndihme më lehtë të arritshme, si zyra e ombudsmanit, e këshillimit dhe e ndërmjetësimit;
4. Duhet luftuar racizmi dhe ksenofobia në politikë dhe stereotipet në medie;
5. Lufta kundër racizmit dhe diskriminimit duhet të jetë pjesë e një politike integrale për të drejtat e njeriut e realizuar nga konfederata, kantonet dhe komunitat.

Këto pesë pika duhen aplikuar edhe në marrëdhëniet me pakicën muslimane që jeton këtu në Zvicër. Për ta arritur këtë neve na nevojitet të mësojmë se sa stereotipe e paragjykime e përshkojnë të folurit dhe shkrimin për njerëzit e besimit islam këtu te ne dhe si mund të shpijë kjo konkretisht te diskriminimi dhe shkarjet raciste.

Duke e njohur realitetin pluralist dhe multifetar të vendit tonë; duke besuar se respekti dhe toleranca e ndërsjellë e të gjithë njerëzve e mundësojnë një të ardhme të përbashkët dhe e lehtësojnë bashkëjetesën; duke konsideruar se diskriminimi (përjashtimi shoqëror) bie ndesh me konceptin demokratik të shtetit, **KFR-ja rekomandimet në vijim ua drejton:**

anëtarëve të shoqërisë civile:

1. Paragjykimet duhen eliminuar përmes takimeve plot respekt dhe përmes kontakteve të ndërsjella në shkollë, në vendin e punës, në kohën e lirë, me fqinjët etj. Për këtë qëllim ekzistojnë burime të ndryshme për një sërë programesh përkatëse.
2. Në ballë të kontakteve duhet të qëndrojnë jo pikat që na ndajnë, siç vërehet shpesh nëpër debate publike, porse ato të përbashkëtat dhe mirëkuptimi i ndërsjellë.

3. Një pjesëmarrje e përbashkët në organet ekzistuese shoqërore dhe politike krijon mirëbesimin e ndërsjellë.

autoriteteve federale:

4. Duhet respektuar liria fetare dhe ndalimi i diskriminimit i shprehur në kushtetutën zvicerane si dhe duhen zbatuar të gjitha dispozitat jodiskriminuese të konventave të ndryshme për të drejtat e njeriut të OKB-së dhe KE-së.
5. Çdo akt diskriminimi dhe mekanizmi të përjashtimit social prej të cilëve vuajnë muslimanët, duhet luftuar në mënyrë më aktive nga ana e autoriteteve dhe politikanëve. Në sektorët ku përkatësia fetare nuk guxon të ketë rëndësi, bëjnë pjesë edhe vendi i punës dhe strehimi.
6. Lufta kundër terrorizmit nuk guxon të shpijë në minimin e të drejtave të njeriut dhe ato elementare si dhe në një barazim të muslimanëve me terroristët.
7. Në bazë të trajtimit të barabartë të të gjitha drejtimeve fetare dhe institucioneve të tyre në Zvicër, nëpër kantone duhen krijuar baza adekuate juridike për një njohje publike-juridike të bashkësive fetare të muslimanëve.
8. Definicioni "pakica kombëtare fetare" sipas Marrëveshjes Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, duhet aplikuar edhe për bashkësinë muslimane.
9. Muslimanëve që e praktikojnë besimin e tyre duhet t'u sigurohet kujdesi për mishin e prerë (mishin hallal).

autoriteteve ekzekutive të kantoneve e komunave:

10. Rregullimet ndërtimore dhe rajonale duhen bërë në mënyrë më fleksibile, me qëllim që të mundësohet themelimi i qendrave fetare dhe ndërtesave të kultit. Autoritetet nuk duhet ta mbështesin presionin populist në drejtim të trajtimit jo të barabartë të muslimanëve.
11. Rregullimi i varrezave kantonale gjegjësisht komunale duhet të ndryshohet në atë formë që në varrezat publike të sigurohet një varrim edhe sipas riteve islame. Hapja e këtyre varrezave duhet diskutuar edhe për pakicat e tjera fetare.

punëdhënësve dhe sindikatave:

12. Përmes modeleve dhe direktivave etike, në vendin e punës duhet të stimulohet një klimë e vlerësimit dhe nderimit të njëjtë të punëtorëve, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre fetare.
13. Këto direktiva duhet të përfshihen në kontratat e përgjithshme të punës.

14. Nëpër vendet e punës duhet të garantohet ushtrimi i lirë i besimit dhe i njëjti të mundësohet më anë të masave të përshtatshme.
15. Përkatësia fetare nuk guxon që me rastin e punësimit të vlerësohet si një kriter negativ.
16. Për raste të përndjekjes, përjashtimit social ose diskriminimit, brendapërbrenda punëtorisë duhen themeluar pika kontakti.

përgjegjësve të edukimit dhe arsimit:

17. Themelimi i katedrave për shkencat fetare islame në shkollat e larta publike.
18. Mësimi nëpër shkolla duhet t'i përshtatet realitetit multifetar të klasave shkollore. Kjo mund të ndikojë në organizimin e shkollave, në mësimdhënie e në planin mësimor si dhe në mjetet e mësimt e në strukturimin e lëndëve. (Si shembull mund të merret lënda e re "Feja dhe kultura" e inkorporuar në kantonin e Zürichut).
19. Stimulimi jodiskriminues i udhëzimeve fetare nëpër hapësirat shkollore përmes përgatitjes së infrastrukturës.
20. Trajtimi i barabartë i të gjitha feve me rastin e ofrimit të përjashtimeve (nga gjërat që i duan ato) dhe në implementimin e sistemit të ditëve festive.

punonjësve të medieve:

21. Me rastin e zbatimit të Deklaratës për detyrimet dhe të drejtat e gazetarëve, kujdes i veçantë duhet kushtuar mospërdorimit të stereotipizimit (shabllonizimit) të muslimanëve nëpër tekste, tituj dhe fotografi.
22. Pjesëtarët e pakicave që jetojnë në Zvicër nuk guxojnë të fajësohen për ngjarjet që ndodhin jashtë vendit. Duhet evituar formulimet që reflektojnë një dyshim të gjithëmbarshëm.
23. Zhvillimi i bisedave me njerëzit e besimit islam – jo të flitet / shkruhet *për* pakicat, porse të flitet / shkruhet bashkë *me* ta.

Nga gjermanishtja:
mr. Rejhan Neziri